

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7182
E hënë, 13 maj 2024
Çmimi 0.50

Çfarë bën Zyra e Kinës në Prishtinë? | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EUROACTIV: FILLIM I RI PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI PAS ZGJEDHJEVE EVROPIANE?

| FAQE 5



Derisa po pritet një progres në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë, marrëveshja e Ohrit, që u negociua nga Bashkimi Evropian në marsin e kaluar, po përballet

me një ngërc të ri. Sipas rrjetit të pavarur mediatik pan-evropian, Euractiv, as Beogradi dhe as Prishtina nuk duket të jenë në disponim ta zbatojnë

marrëveshjen dhe, në vend të kësaj, po mbajnë shpresat të lidhura me ndryshimet në leadershipin e Evropës dhe të ShBA-së për ta rinisur dialogun

STUDENTËT E INFERMIERISË PARALAJMËROJNË IKJEN NË GJERMANI NËSE NUK U PLOTËSOHEN KUSHTET E PUNËS | F. 3



FAMILJA JASHARI I PËRGJIGJET PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË | F. 4-5



AKTUALE



DAVKOVA BETOHET SI PRESIDENTE E MAQEDONISË SË VERIUT | F. 2

300 ANËTARËSIME TË REJA NË LV, KURTI: PRIZRENI PO E FORCON LIDHJEN ME VETËVENDOSJEN | F. 3

KURTI BËN HOMAZHE TE VARRI I HEROIT AGRON RRAHMANI | F. 6

EKONOMI



"DAL NË TREG E KTHEHEM ME DUAR NË XHEPA": A I KONTROLLON KUSH ÇMIMET? | F. 8

SPORT



BALLKANI E LLAPI VAZHDOJNË ME FITORE, DRITA NGEÇ | F. 12

BASKETBOLL / YLLI BARAZON SERINË FINALE NDAJ TREPÇËS | F. 12

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Davkova betohet presidente e Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 12 MAJ - Gordana Silanovska-Davkova e ka bërë betimin të dielën si gruaja e parë presidente e Maqedonisë së Veriut prej pavarësimi të vendit në vitet '90, pasi i fitoi zgjedhjet presidenciale më 8 maj. Ajo iu referua Maqedonisë së Veriut me emrin e vjetër gjatë ceremonisë. Davkova e mposhti presidentin e deritanishëm, Stevo Pendarovski, duke fituar dyfish më shumë vota se ai në balotazhin e së mërkurës. Pasi u betua gjatë një seance para përbërjes në largim të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Davkova, megjithatë, gjatë fjalimit të saj e shmangu fjalën "e veriut" në emrin e shtetit, ashtu siç kishte paralajmëruar gjatë fushatës së saj.

Davkova u betua se "do ta mbroj sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë" duke e shmangur emrin kushtetues të vendit, Maqedonia e Veriut.

Në vitin 2018 u arrit një marrëveshje në Prespë me Greqinë për ndryshimin e emrit nga Maqedoni në Maqedonia e Veriut, duke u dhënë fund mosmarrëveshjeve shumëvjeçare dhe duke ua hapur rrugën përpjekjeve të vendit për integrim në BE dhe NATO.

Ambasadorja e Greqisë në Shkup, Sofia Filipidou, e braktisi ceremoninë e betimit të presidentes në shenjë proteste pse Davkova e përmendi emrin e vjetër "Republika e Maqedonisë"



gjatë procesit, sipas deputetit të VMRO DPMNE-së, Antonio Milloshoski.

Për protestën e diplomates greke kanë njoftuar edhe mediet greke. "Ambasadorja e Greqisë në Maqedoninë e Veriut, Sofia Filipidou, e ftuar në seancën e Kuvendit për betimin e Gordana Silijanovska, u largua në shenjë proteste për shkak se gjatë betimit ka shkelur Marrëveshjen e Prespës", shkroi gazeta greke "Prototema". "Do të jem presidente e të gjithëve, edhe pjesës së majtë edhe asaj të djathtë të Kuvendit; presidente e të gjithë qytetarëve pavarësisht

përkatësisë së tyre etnike, fetare apo politike", ka thënë Davkova. Megjithatë, Davkova në fjalimin e saj nuk foli për çështje që kanë të bëjnë me procesin e integritetit evropian të vendit, i cili varet nga ndryshimet kushtetuese bazuar në një marrëveshje me Bullgarinë, por tha se do të punojë për "evropianizimin e vendit së bashku me shtetet e tjera të Ballkanit".

Davkova nuk e mbështet ndryshimin e Kushtetutës, por në një intervistë dhënë Radios Evropa e Lirë së voni, tha se nëse Kuvendi i miraton amendamentet kushtetuese - të cilat do të

mundësonin që bullgarët dhe pesë pakicat e tjera etnike të bëheshin pjesë e Kushtetutës maqedonase - ajo do t'i respektonte ato.

Ndërkohë, Davkova tha se tani "është koha për bashkim" dhe për këtë ajo do t'u drejtohej grave, "sepse duam të tregojmë se nuk kujdesemi vetëm për veten, por edhe për të gjithë rreth nesh. Besimi është shumë i rëndësishëm, dhe unë do ta arsyetoj atë".

Ajo u zotua se kabineti i saj presidencial do ta pasqyrojë përbërjen etnike të vendit, "ku do të ketë vend edhe për

maqedonasit, shqiptarët dhe përfaqësuesit e entiteteve tjera, ndërsa përzgjedhja e tyre do të bëhet bazuar në kriteret profesionale dhe jopartiake". Në sallën e Kuvendit ishin përfaqësuesit e të gjitha partive të përbërjes parlamentare para zgjedhjeve të 8 majit.

Cilat janë kompetencat e presidentit të Maqedonisë së Veriut?

Presidenti në Maqedoninë e Veriut ka kompetenca të kufizuara.

Presidenti është komandant i përgjithshëm i Forcave të Armatosura të vendit. Ai dekreton mandatarin për formimin e qeverisë së re, emëron dhe shkarkon me dekret ambasadorët, pranon letra kredencialet dhe letrat e revokimit të përfaqësuesve të huaj diplomatikë.

Roli i presidentit është edhe të propozojë dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese si dhe dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor, ta propozojë guvernatorin e Bankës Popullore, të caktojë disa drejtues në postet e sigurisë.

Presidenti, gjithashtu, ka të drejtën e faljes në përputhje me dispozitat ligjore si dhe kryen funksione të tjera të përcaktuara me Kushtetutën maqedonase.

Raportohet se BE-ja do të arrijë pajtueshmëri për garancitë e sigurisë për Ukrainën

BRUKSEL, 12 MAJ - Bashkimi Evropian (BE) është duke biseduar me Kievin për garancitë e mundshme të sigurisë, me qëllim që t'i kryejë "zotimet e mëdha të sigurisë" për Ukrainën deri në fillim të korrikut, raporton gazeta gjermane "Welt am Sonntag".

Kjo gazetë raportoi më 11 maj se e ka parë dokumentin e një drafti në Bruksel, në të cilin diskutohet nëse mund të dërgohen në Ukrainë ushtarë nga vendet e BE-së.

Anëtarët nga 27 vendet anëtare të BE-së "së fundmi u pajtuan" për një tekst "konfidencial" 11-faqesh, sipas gazetës.

"Welt" shtoi se në tekst shkruhet se "përfshihet pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e ushtarëve të BE-së përkrah ushtarëve ukrainas në operacionet luftarake kundër Rusisë".

Por, vendet zotohen, sipas dokumentit, për ta furnizuar



Ukrainën me armë dhe armë jovekdjeprurëse dhe për ta ndihmuar me stërvitje.

Shumica e vendeve të bllokut e kanë ndihmuar Ukrainën prej se Rusia e nisi pushtimin e

paprovokuar dhe të jashtëligjshëm të saj në shkurt 2022.

Ka disa muaj që presidenti i Francës, Emmanuel Macron, nuk e hedh poshtë mundësinë e dërgimit të trupave nga vendet aleate perëndimore të Kievit në Ukrainë.

I pyetur drejtpërdrejt në mars, ai tha se "të gjitha këto opsione janë të mundshme".

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, është përpjekur ta përshkruajë ndihmën ushtarake për Ukrainën si tregues që NATO-ja dhe Perëndimi është i përfshirë tashmë në konflikt.

Shtetet e Bashkuara dhe mbështetësit e tjerë të Kievit e kundërshtojnë këtë portretizim. NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara e kanë kufizuar me kujdes përfshirjen e tyre, për të mos i dhënë Moskës përparësinë në atë që ato e cilësojnë si një luftë pushtuese në Ukrainë, e cila kërcënon rendin dhe sovranitetin ndërkombëtar.

Familja Jashari i përgjigjet procesit të regjistrimit të popullsisë

Skenderaj, 12 maj - Po vazhdon procesi i regjistrimit të popullsisë. Të dielën stafi i Agjencisë së Statistikave ishte te familja e komandantit legjendar Adem Jashari. Ata u pritën nga kryefamiljari, Rifati. "Familja legjendare,

Jashari, përfundoi me sukses obligimin e tyre qytetar, e gjatë procesit nuk mungoi mirëpritja nga ana e tyre me ç'rast u falënderuan nga stafi i ASK-së për të cilët ka mbetur edhe shumë pak kohë deri në përmbylljen e

këtij projekti", thuhet në njoftimin e ASK-së. Regjistrimi i popullsisë ka nisur nga data 5 prill dhe përfundon më 17 maj. Deri më tani raportohet se janë regjistruar 1.3 milion banorë.



Studentët e infermierisë paralajmërojnë ikjen në Gjermani nëse nuk u plotësohen kushtet e punës

Faton DËRMAKU

PRISHTINE, 12 MAJ - Organizata joqeveritare Dita e Infermierëve "Nurseday", e themeluar në fillim të këtij viti nga studentët e drejtimit të Infermierisë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, javën e kaluar, gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ka realizuar një anketim me studentët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë. Leonita Ujkani, kryetare e kësaj organizate, ka thënë se në hulumtim janë përfshirë rreth 30 për qind e numrit të përgjithshëm të studentëve të vitit të parë, të dytë dhe të tretë të drejtimit të Infermierisë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Ujkani thotë se nga ky vit do të jenë zëri i përditshëm i studentëve dhe profesionistëve të drejtimit të Infermierisë. "Në pyetjen se, pas përfundimit të studimeve themelore, a do të qëndroni në Kosovë, apo do të shkoni në një shtet tjetër për të punuar? Nga 91 studentë të vitit

të parë, të dytë dhe të tretë që janë përgjigjur, 52 apo rreth 57 % prej tyre janë deklaruar se do të qëndrojnë në Kosovë për të punuar si infermierë, ndërsa 39 studentë apo rreth 43 % prej tyre janë deklaruar se do të shkojnë në një shtet tjetër për të punuar si infermierë. Te shumica e studentëve, shteti i përzgjedhur është Gjermania. Në pyetjen se, për momentin, a jeni duke shkuar në kurs të gjuhës gjermane apo një gjuhë tjetër, ose a keni në plan për ta filluar kursin, muajve, viteve në vazhdim? Nga 91 studentë të vitit të parë, të dytë dhe të tretë që janë përgjigjur, 57 apo rreth 63 % prej tyre janë deklaruar se për momentin janë duke ndjekur kursin e gjuhëve ose planifikojnë të fillojnë muajve e viteve në vazhdim, ndërsa 34 studentë apo rreth 37 % prej tyre janë deklaruar se për momentin nuk janë duke ndjekur kursin e gjuhëve ose nuk planifikojnë të fillojnë as muajve e viteve në vazhdim. Te shumica e studentëve, është përzgjedhur kursi i gjuhës



gjermane", thuhet në rezultatet e këtij hulumtimi. Ndërkaq në pyetjen se sa duhet të jetë paga për infermierët në institucionet shëndetësore publike, që ju të jetoni e punoni në Kosovë?, Nga 91 studentë të

vitit të parë, të dytë dhe të tretë që janë përgjigjur, 51 apo rreth 56 % prej tyre janë deklaruar se paga për infermierët në institucionet publike duhet të jetë rreth 750 euro, 36 studentë apo rreth 39 % prej tyre janë

deklaruar se paga duhet të jetë rreth 1 000 euro dhe vetëm 4 studentë apo rreth 0.5 % prej tyre janë deklaruar se paga për infermierët në institucionet publike duhet të jetë rreth 500 euro.

Jahjaga takon ish-kryeministrin spanjoll, temë integrimi i Kosovës në strukturat euroatlantike



PRISHTINE, 12 MAJ - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, gjatë qëndrimit të saj në Madrid, e ka takuar ish-kryeministrin spanjoll Jose Luis Rodriguez Zapatero. Jahjaga ka bërë me dije se me Zapateron kanë biseduar edhe për "domosdoshmërinë e integrimit të Kosovës dhe

mbarë rajonit në strukturat euroatlantike". "Biseduam për zhvillimin e Kosovës përgjatë 20 viteve të fundit, si dhe për nevojën dhe domosdoshmërinë e integrimit të Kosovës dhe mbarë rajonit në strukturat euroatlantike. Gjithashtu, si një feminist i vërtetë,

biseduam edhe për pozitën e gruas në shoqëritë tona", është shprehur Jahjaga. Ish-shefja e shtetit ka falënderuar ish-kryeministrin spanjoll për shërbimin e trupave spanjolle brenda KFOR-it në Kosovë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

300 anëtarësime të reja në LV, Kurti: Prizreni po e forcon lidhjen me Vetëvendosjen

PRIZREN, 12 MAJ - "Prizreni po e forcon lidhjen me Vetëvendosjen, dhe kryeqyteti i kulturës e i historisë shumë shpejt do t'i kthehet punës së mbarë progresiste dhe lidhjes me mirëqeverisjen demokratike", ka thënë kryeministri, njëherazi kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në takim me mbajtje me qindra anëtarë të rinj që i janë bashkuar kësaj partie në

Prizren. "Rruga Prizren - Tetovë, hekurudha që do ta lidhë Prizrenin me Gjakovën dhe Shkodrën, janë dy prej projekteve në infrastrukturë që kemi filluar e që do të kontribuojnë si në lidhjen e shqiptarëve, po ashtu edhe në zhvillimin ekonomik të Prizrenit", tha kryeministri, i cili kujtoi spitalin e këtij qyteti dhe Universitetin "Ukshin Hoti" që

në këto tre vite janë transformuar. Kurti ka thënë se në Prizren kishin një shkëputje të shkurtër, por do të rikthehen dhe, sipas tij, këtë e dëshmon anëtarësimi i lartë dhe i vazhdueshëm i qytetarëve në LV. "Prizreni frymon me Lëvizjen. Për këtë jemi garantues secili prej nesh dhe të gjithë ne së bashku", ka thënë Kurti.





Çfarë bën Zyra e Kinës në Prishtinë?

PRISHTINË, 12 MAJ - Me fjalët e inteligjencës perëndimore, Kina përbën një kërcënim në rritje për sigurinë globale. Përshkruhet si një fuqi që synon supremacinë dhe përpiket ta shfrytëzojë epërsinë e saj ekonomike për të arritur qëllime politike.

Shteti komunist, në dekadën e fundit, ka zgjeruar dukshëm ndikimin e tij në Ballkan, duke krijuar lidhje më të forta me disa qeveri dhe duke u përqendruar në sektorë specifikë, si infrastruktura apo energjia, për bashkëpunim. Në vende si Serbia përfshirja kineze vërehet, madje, edhe në kulturë, media dhe arsim.

Përrjashtim nga ky model përbën Kosova, thonë autoritetet e saj. Ndonëse prej Kinës importon mallra në vlerë prej qindra miliona eurosh në vit, vendi nuk ka lejuar ndonjë investim për madh kinez apo ndikim tjetër.

Kina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, por respekton, siç thotë, integritetin territorial të Serbisë, e cila, me Kushtetutë, Kosovën e trajton ende si pjesë të territorit të saj.

Rrjedhimisht, dy vendet nuk kanë

as marrëdhënie diplomatike, por, prej vitesh, Kina ka në Kosovë një zyrë ndërlidhëse, e cila funksionon nën Ambasadën kineze në Beograd.

Radio Evropa e Lirë i kontakttoi të dyja këto institucione për t'i pyetur rreth aktiviteteve të saj, por nuk mori përgjigje.

Ekipi i REL-it ishte i pranishëm edhe tek objekti i zyrës në Lagjen Arbëria në Prishtinë, më datën 7 maj, por sigurimi aty tha se nuk ka personel brenda dhe se ka "rreth dhjetë ditë" që aty nuk ka qenë dikush.

Në ueb-faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, ku janë të listuara ambasadat dhe misionet e huaja në Kosovë, figuron edhe Zyra Ndërlidhëse e Kinës. Aty janë publike disa kontakte, por ueb-faqja e zyrës, që do të mund të ofronte informacione për aktivitetet e saj, nuk është funksionale.

E pyetur nga Radio Evropa e Lirë se a e përcjell punën e Zyrës së Kinës në Kosovë, a ka kontakte me të dhe a merr ndonjë raport prej saj, Qeveria e Kosovës, në përgjigjen e përbashkët me

MPJD-në, nuk ofroi shumë detaje. "Sigurisht që ne jemi në dijeni për praninë e të gjitha misioneve që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe për aktivitetet e tyre në vend. Sa i përket Zyrës së Kinës në Kosovë, ne si Qeveri nuk kemi ndonjë komunikim me të, marrë parasysh raportet ndërmjet dy vendeve", thuhet në përgjigje.

Radio Evropa e Lirë pyeti edhe Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, se çfarë kontaktesh ka me Zyrën e Kinës në Kosovë dhe a asiston në komunikimet mes saj dhe institucioneve të Kosovës, por nuk mori përgjigje.

Në ueb-faqen e UNMIK-ut shkruan se më 16 shkurt të këtij viti, shefja e këtij misioni, Caroline Ziadeh, ka pritur shefin e Zyrës së Republikës Popullore të Kinës në Prishtinë, Cheng Lei. Mes të tjerash, thuhet se Ziadeh ka vënë në pah "iniciativat e UNMIK-ut për ndërtimin e besimit", por nuk specifikohet më shumë.

Nga kërkimet që bëri Radio Evropa e Lirë në internet rezultoi se, muajin e kaluar,

Cheng është pritur edhe nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Në platformën LinkedIn, Rama ka shkruar se me zotën Cheng kanë diskutuar "mundësi të shumta të bashkëpunimit" në fushat e ekonomisë, artit e kulturës.

"U informova se Qeveria e Kinës, deri tani, ka lëshuar viza për më shumë se 1.000 përfaqësues biznesesh nga Kosova", ka thënë, mes tjerash, Rama.

Po në prill, Cheng ka takuar edhe kryetarin e Ferizajt, Agim Aliu. Ky i fundit, në një postim në "Facebook", ka shkruar se në takim, mes tjerash, është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme e veçanërisht në lehtësimin e të bërit biznes.

Jashtë politikës, Cheng është pritur nga kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili ka thënë se ka kërkuar nga Cheng që, përmes Zyrës së Kinës, komitetet olimpike të të dyja vendeve të lidhin bashkëpunim në fushën e sportit - për ç'gjë diplomati kinez është pajtuar.

Mimoza Ahmetaj, e cila ka

shërbyer si ambasadore e Republikës së Kosovës në disa shtete, thotë për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se Kosova duhet të përfitojë nga prania e secilit mision të huaj diplomatik në vend, përfshirë edhe atë të Kinës. Partneriteti i ndërtuar me to, thotë ajo, do të shërbente, pastaj, në realizimin e objektivave të vetë Kosovës. "Bashkëpunimi në mes shteteve është në disa dimensione - politik, diplomatik, në aspektin e sigurisë, kulturor, tregtar, ekonomik... Pra, është një gamë e gjerë bashkëpunimi. Normalisht që neve na intereson ta faktorizojmë Kosovën dhe duhet gjetur forma... Unë nuk do të doja që Kosova të ndërtonte mure mes shteteve, por, përkundrazi, ura bashkëpunimi", thotë Ahmetaj. Një që ka publikuar muajin e kaluar Instituti Ndërkombëtar Republikan, me seli në ShBA, ka gjetur se 69 për qind e qytetarëve në Kosovë nuk besojnë se interesat e vendit të tyre avancohen duke mbajtur marrëdhënie të forta me Kinën. Ramadan Ilazi, nga Qendra

Euroactiv: Fillim i ri për dialogun Kosovë - Serbi pas zgjedhjeve evropiane?

PRISHTINË 12 MAJ - Derisa po pritet një progres në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë, marrëveshja e Ohrit, që u negociua nga Bashkimi Evropian në marsin e kaluar, po përballet me një ngërç të ri. Sipas rrjetit të pavarur mediatik pan-evropian, Euractiv, as Beogradi dhe as Prishtina nuk duket të jenë në disponim ta zbatojnë marrëveshjen dhe, në vend të kësaj, po mbajnë shpresat të lidhura me ndryshimet në lidhshmëri të Evropës dhe të ShBA-së për ta rinisur dialogun. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe ish-kryeministrja Ana Brnabić kanë deklaruar në mënyrë të prerë kundërshtimin e tyre ndaj njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe do të punojnë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në institucionet e tjera

ndërkombëtare, shkruan Telegrafi. Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po zvarrit zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në veri të Kosovës, një marrëveshje për të cilën kanë rënë dakord prej kohësh dhe që Prishtina argumenton se shkel Kushtetutën e vendit dhe ka frikë se mund të përfundojë në një dështim si ndodhi me Republika Srpskan në Bosnjë-Hercegovinë. Kushtet e marrëveshjes së Ohrit janë tashmë pjesë e kuadrit të negociatave të pranimit në BE për Beogradin, në Kapitullin 35, ku ambasadorët e BE-së ranë dakord me një mendje në mes të prillit. Ndërmjetësit e BE-së janë shprehur të pakënaqur me mungesën e progresit, edhe pse përpjekjet e Brukselit dhe

Washingtonit deri më tani nuk kanë sjellë rezultate të dukshme. Kjo ndërprerje rritet edhe më shumë për shkak të zgjedhjeve të ardhshme në Evropë dhe ShBA, ku Vuçiq veçanërisht duket të ketë vendosur shpresat e tij për një kthim të mundshëm të Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë, i cili kishte mbështetur idenë e një shkëmbimi teritorësh në mes të Kosovës dhe Serbisë në mandatin e tij të parë. Ndërkohë, pozicionet kyçe që lidhen me dialogun po përgatiten për ndryshime të mëdha, pasi i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, po largohet nga posti dhe emri i pasardhësit të tij mbetet i paqartë. Në BE, Miroslav Lajčak pritet ta lërë postin deri në gusht, dhe emri i ish-presidentit sloven Borut Pahor po përmendet si një ndër pasuesit e

mundshëm. Dyshimet lidhen edhe me të ardhmen e kryediplomatit të ri të BE-së, që do ta zëvendësojë Josep Borrellin, dhe nuk pritet ta marrë detyrën deri në fund të vitit. “Ndërsa ndërmjetësuesit e rinj kanë një shans për ta përmirësuar dinamikën, ka më shumë probleme strukturore, siç është mungesa e një perspektive të besueshme anëtarësimi në BE”, tha për Euractiv, Florian Bieber, profesor në Universitetin e Grazit. Sipas tij, “Ata kanë nevojë për një qasje të re me angazhime të qëndrueshme dhe transparente dhe një BE më të fuqishme”. “Nëse Komisioni i ardhshëm Evropian, siç pritej, do të jetë një komision i përqendruar te zgjerimi, ekziston mundësia që ato procese politike të shikohen më nga afër”, tha një zyrtar i BE-

së. “Ne mund të shohim më shumë stimuj dhe më shumë presion të aplikuar mbi të gjitha palët”. Kjo periudhë tranzicioni duket se do të sjellë një periudhë stagnimi në dialog, me takime të nivelit të lartë që duket se kanë pak gjasa të ndodhin. Megjithatë, ka ende shpresë që cikli i ri institucional do t'i rifreskojë negociatat, me mundësi që një perspektivë reale e integritit në BE dhe avantazhet financiare që vijnë me procesin e zgjerimit do të jenë një ndikim pozitiv. Sidoqoftë, sfidat mbeten të mëdha nga qëndrimi i serbëve ndaj BE-së deri te pengesat e Kosovës për të bërë përparim në rrugën e saj drejt BE-së - kështu që vetëm koha do të tregojë se si do të lëvizin gjërat nga këtu, raporton Euractiv.



Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë për Exposenë se ky perceptim është krijuar nga mungesa e marrëdhënieve formale politike ndërmjet dy vendeve. Ai thotë se institucionet e Kosovës duhet të jenë shumë të kujdesshme ndaj rolit që mund të luajë Zyra Ndërlidhëse e Kinës. “Në mungesë të kontakteve domethënëse me Qeverinë e nivelit qendror, Kina po përpiqet të hyjë në nivele të tjera të qeverisjes. Kjo është potencialisht shqetësuese dhe institucionet e Kosovës duhet të japin udhëzime më të mira se si të trajtohen kërkesat për takime nga Qeveria kineze”, thotë Ilazi. Ilazi shton se në dëm të Kosovës shkon edhe mbështetja shumë e fortë e Kinës për Serbinë. Këtë javë, presidenti i Kinës, Xi Jinping, qëndroi për vizitë

zyrtare në Beograd, ku përsëriti se Pekini e mbështet qëndrimin e Serbisë për çështjen e Kosovës. Xi tha, po ashtu, se Serbia është partnerja kryesore e Kinës në Evropën Qendrore dhe Lindore. Sipas Ilazit, forcimi i kësaj aleance paraqet pengesë të madhe për njohjen e plotë ndërkombëtare të Kosovës, meqë Kina është anëtare e përhershme, me të drejtë vetoje, e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara - organizatë ku Kosova mëton të anëtarësohet. Ilazi thotë se Kosova duhet të jetë “potencialisht e hapur për një nivel të marrëdhënieve diplomatike me Kinën”, por se “këtë duhet ta bëjë në koordinim të plotë me SHBA-në”. Pro një politike më të hapur shprehet edhe ish-diplomatja Ahmetaj. “Është e rëndësishë së

veçantë ndërtimi i raporteve me këto misione. Duhet gjetur mënyrën se si të bashkëpunojmë me secilin prej tyre dhe si të përfitojmë nga prania e tyre. Në asnjë moment, të mos i shikojmë si të padëshiruara. Kosova është në proces të shtetndërtimit, në proces të konsolidimit të shtetit dhe prania e tyre duhet t'i shërbejë Kosovës në këtë frymë”, thotë ajo. Për të vizituar Kosovën, qytetarët kinezë duhet të pajisen me vizë, përveç atyre që kanë pasaporta diplomatike. Vizat mund të merren në ambasadën e Kosovës në Shqipëri ose Turqi. Ngjashëm, edhe qytetarët e Kosovës duhet të kenë viza për të shkuar në Kinë - dokumentet i dorëzojnë në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë, ndërsa shqyrtohen në Ambasadën e Kinës në Beograd.

Kosova dhe Kina nuk kanë ndonjë marrëveshje formale bashkëpunimi. Në Kosovë nuk ka ndonjë medium me pronësi kineze, apo me përmbajtje pro-kineze. Kosova, po ashtu, nuk ka ndonjë kredi nga bankat kineze. Ato që janë evidente, janë shkëmbimet tregtare. Nga të dhënat që ka siguruar Radio Evropa e Lirë nga Dogana e Kosovës, rezultojnë se në vitin 2023, Kosova ka importuar nga Kina mallra në vlerë prej 650 milionë eurosh. Shifra ka arritur gati dyfishin e vitit 2019, kur kjo vlerë ka qenë 340 milionë euro. Vlera e eksporteve të Kosovës në Kinë, ndërkaq, ka qenë 442 mijë euro vitin e kaluar. Dogana e Kosovës ka konfirmuar, po ashtu, se në mesin e importeve nga Kina vitin e kaluar, kanë qenë edhe 57.444 pajisje incizuese. Radio Evropa e Lirë ka zbuluar se

shumë kamera nga Kina, të kompanive Dahua dhe Hikvision, janë të instaluar në sheshet e Prishtinës, si dhe në ndërtesat qeveritare, përfshirë Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Ministrinë e Tregtisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Çështja është jo pak shqetësuese kur merret parasysh se dy kompanitë Dahua dhe Hikvision, pjesërisht në pronësi të shtetit kinez, janë në listën e zezë të SHBA-së, Britanisë dhe Australisë. Janë disa shtete perëndimore si këto që Kinën e perceptojnë si aktore keqdashëse, e cila në disa raste është angazhuar në fushata dezinformuese që e portretizojnë komunitetin perëndimor si të dështuar dhe joefektiv. Edhe vetë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në disa raste e ka përshkruar Kinën si “armike”.



Kurti bën homazhe te varri i heroit Agron Rrahmani

Prishtinë, 12 maj - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri homazhe të dielën dhe vendosi lule te freskëta në nderim të dëshmorit Agron Rrahmani, në përvjetorin e rënies së tij heroike. “U përkujtua maji i vitit 1998, kur brenda gjashtë ditësh, rezistenca e armatosur për çlirimin e Kosovës mori goditje

të rënda nga humbja e Bahri Fazliut, Ilir Konushevcit dhe Agron Rrahmanit. Bahriu u vra më 7 maj, Iliri më 9 maj, kurse Agroni më 12 maj. Sot u bënë nderime në 26-vjetorin e rënies së Agron Rrahmanit, i cili u vra në lagjen e Muhaxherëve në Prishtinë, më 12 maj 1998. Për ta përkujtuar Agron Rrahmanin, Kryeministri Kurti

bëri homazhe te varri i tij në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë, ku janë pranë një-tjetrit edhe varret e bashkëluftëtarëve. Lavdi dëshmorit Agron Rrahmani, i rënë për lirinë e Kosovës bashkë me shokët dëshmorë, Bahri Fazliun dhe Ilir Konushevcin”, tha kryeministri Kurti.

Një muaj paraburgim për një të dyshuar për huliganizëm në veri

PRISHTINË, 12 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar të dielën se ia ka shqiptuar masën prej një muaji paraburgim një të dyshuari me inicialet S. M., i cili akuzohet për veprimtari kundër Kushtetutës së vendit dhe për huliganizëm, në lidhje me dhunën e majit të vitit 2023 në veri të Kosovës.

Në një njoftim për medie, gjykata tha se e ka pranuar kërkesën e prokurorëve, sepse “nëse i pandehuri lihet në liri, ai mund të arratiset, apo mund t’i ndryshojë provat e veprës penale dhe të ndikojë tek të dyshuarit e tjerë që gjenden të lirë”.

Verën e vitit të kaluar Policia e Kosovës arrestoi dhjetë pjesëtarë të komunitetit serb për sulme ndaj pjesëtarëve të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, për akuzat kundër rendit kushtetues të Kosovës dhe për sulme ndaj gazetarëve.

I dyshuari, shtetas serb,

ngarkohet me veprat penale “bashkim për veprimtari kundërkushtetuese”, “rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare”, “pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, si dhe për “veprën penale sulm ndaj personit zyrtar”, tha gjykata.

Gjykata nuk tregoi se kur ishte arrestuar i dyshuari.

Në veri tensionet u rritën vitin e kaluar pasi Policia e Kosovës asistoi që në ndërtesat komunale të hynin kryetarët e rinj shqiptarë. Kjo u kundërshtua nga popullata vendase serbe, që nuk pranoi rezultatet e zgjedhjeve lokale të prillit, votime që i bojkotoi.

Situata u përshkallëzua më 29 maj, kur serbët u përleshën me KFOR-in dhe mbi 100 persona u plagosën nga të dyja palët.

Gjykata tha të dielën se S. M. dyshohet se “me një grup të dyshuar ka qenë pjesëmarrës i protestave të organizuara me



datë 29.05.2023 para objektit të komunës së Zveçanit, duke sulmuar pjesëtarë të KFOR-it dhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës”. Në fund të shkurtit këtë vit, dy të dyshuar, Radosh Petroviq dhe

Dushan Obrenoviq, arritën një marrëveshje me Prokurorinë Speciale të Kosovës, pasi pranuan fajësinë për veprën “pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm”. Ata ishin

arrestuar më 29 maj të vitit të kaluar në Zveçan, gjatë përleshjeve mes protestuesve serbë dhe pjesëtarëve të KFOR-it. Pas pranimit të fajësisë, ata janë lënë të lirë.

Dita e Dëshmorëve të Rahovecit, Haradinaj: Rahoveci ka dëshmuar kontribut ndaj atdheut



RAHOVEC, 12 MAJ - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të dielën në Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Rahovecit. Haradinaj ka thënë se Rahoveci e ka dëshmuar kontributin ndaj atdheut në luftën e fundit për liri përmes shumë luftëtarëve të zotë saqë edhe historia do të rrëfejë për ta te brezat e ardhshëm. “Më 12 maj 1998, pushkët e luftëtarëve të lirisë kumbuan në Anadrini. Betejat në Ratkoc, Vrajakë, Bratotin e Malësi të Vogël, shënuan një kapitull të ri për Luftën Çlirimtare në Zonën

Operative të Pashtrikut. Jo rastësisht 12 maji shënohet si Ditë e Dëshmorëve në Komunën e Rahovecit. Atë ditë ranë heroikisht, Milaim Krasniqi dhe Elmi Morina. Një vit më pas, ra dëshmor një nga luftëtarët më të dalluar në rrethin e Anadrinisë, Bedrush Gashi. Sot, i shoqëruar nga kryetari i Rahovecit Smajl Latifi, mora pjesë në manifestimin qendror kushtuar Ditës së Dëshmorëve, në Kompleksin Memorial në Gradish. Sot kujtojmë gjithashtu, në ditën e përjetësismit,

udhëheqësin e njësiteve të hershme guerile të UÇK-së, Agron Rrahmani”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se, po ashtu, kujtojnë e nderojnë të rënë në Katundin e Ri të Pejës, të ekzekutuar nga dora e shtetit fashist serb. “Kujtojmë rënien por dhe humbjen pa gjurmë të anëtarëve të familjes atdhetare Prelvukaj. Lavdi të gjithë atyre që u flijuan për lirinë e Kosovës ndër breza! Respekti dhe mirënjohja për sakrificën e tyre sublime do të jetë e përherëshme!”, ka theksuar Haradinaj.

Pushojnë hetimet ndaj tre zyrtarëve komunalë të Prishtinës, Rama e quan fitore të drejtësisë

PRISHTINË, 12 MAJ - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pushuar hetimet ndaj zyrtarëve komunalë, Fadil Aliu, Vehbi Mujku dhe Valbona Makiqi, pasi këta të fundit u ndaluan nga Policia e Kosovës për shkak të ngritjes së kallëzimit penal nga Ministria e Drejtësisë. Kryetari i Prishtinës, Përparim

Rama, ka bërë me dije se hetimet janë pushuar me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi se zyrtarët komunalë kanë kryer veprë penale për të cilën ata akuzohen. “Shumë eksponentë politikë tentuan të shfrytëzojnë këtë ndalim të padrejtë për kauzat e tyre politike, duke tentuar të njollosin imazhin e zyrtarëve

tonë dhe për ta goditur qeverisjen tonë në kryeqytet. Por edhe në këtë rast sikur në rastin e stopimit të ndërtimit të Rrugës ‘Jim Xhema’, ata dështuan, drejtësia fitoi”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka thënë se do të vazhdojnë punën për të mirën e qytetarëve të kryeqytetit dhe nuk do të ndalen.



“Dal në treg e kthehem me duar në xhepa”: A i kontrollon kush çmimet?

PRISHTINË, 12 MAJ - “Prapë janë rritur çmimet...”, thotë Hysen Sylejmani teksa shëtit nga tezgja në tezgë në Tregun e Gjelbër të Prishtinës. “Shumë herë dal në treg për t’u furnizuar me produkte ushqimore, por kthehem në shtëpi me duar në xhepa”, thotë pensionisti rreth 80 vjeç.

Radio Evropa e Lirë bisedoi me të mëngjesin e së mërkurës, kur në njërin dorë mbante disa kilogramë miell, e në tjetrën pak litra qumësht. “Më duhet të blej edhe disa pemë dhe perime - domate, tranguj, por nuk e di...”, thotë ai dhe prapë kthen shikimin nga tezgat.

Pohimet e Sylejmanit i mbështesin edhe të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

Të fundit - për muajin mars - tregojnë se çmimet e konsumit janë më të larta për 2.3 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Vetëm prodhimet bujqësore, ndërkaq, janë më të shtrenjta për 5.3 për qind.

Çmimet, megjithatë, duket se ndryshojnë dukshëm varësisht lokacionit dhe dyqanit ku shiten produktet.

Në Prishtinë ekipi i REL-it vërejt çmime të ndryshme të produkteve të njëjta në disa raste - më të larta në dyqane, më të lira në treg.

Në Tregun e Gjelbër një kilogram domate mund të blihet 1 euro, ndërsa në disa dyqane të kryeqytetit çmimi i tyre shkonte deri në 2.15 euro.

Te specat dallimi ishte nga 1.30 euro në treg në mbi 3 euro në dyqane, ndërsa në qepët nga 0.50 euro në 1 euro.

Këtë dallim thotë se e ka vërejtur edhe Elvane Berisha, e cila po furnizohet në Tregun e Gjelbër të Prishtinës, larg lagjes ku jeton. “Unë jetoj në Breg të Diellit. Në dyqane çmimet janë katastrofë, dy-tre fish më të larta”, thotë ajo.

Pensionistja 67-vjeçare thotë se është me fat që e ndihmojnë fëmijët, sepse me pensionin që



merr - 260 euro në muaj - druan se nuk do t’ia dilte.

Radio Evropa e Lirë pyeti kompanitë tregtare “Interex”, “VivaFresh” dhe “ETC” - të cilat kanë dyqane në qytete të ndryshme të Kosovës - se përse produktet bujqësore që i shesin kanë çmime disa fish më të shtrenjta se në treg, por asnjëra prej tyre nuk u përgjigj. “Asnjë ditë asnjë mall nuk e ka çmimin e njëjtë”, thotë, në anën tjetër, Bukurija. “Nuk e di se qysh po ia dal”, thotë ajo, duke treguar se jeton me ndihmë sociale prej 150 eurosh në muaj.

Në treg thotë se nuk shkon, sepse i duhet të paguajë edhe për transport. Furnizimet i bën në dyqane kur, siç thotë, ka aksione, apo lirim çmimesh. “Askujt nuk i intereson për neve që jetojmë me më pak të ardhura. A duhet dikush t’i ndalë këto rritje çmimesh?”, pyet ajo.

Për mundësinë e krijimit të ndonjë mekanizmi që kontrollon rritjen e çmimeve, Radio Evropa e Lirë pyeti Qeverinë e Kosovës, por nuk mori përgjigje.

Më herët, zyrtarë të saj kanë thënë se Kosova ka ekonomi të

lirë të tregut dhe se institucionet e saj nuk mund ta kontrollojnë lëvizjen e çmimeve.

Me këtë nuk pajtohet Ferat Shala, kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në Kuvendin e Kosovës, i cili vjen nga radhët e opozitës.

Ai thotë se Qeveria duhet të krijojë mekanizma që e monitorojnë dhe menaxhojnë “lëvizjen e pakontrolluar” të çmimeve në tregun e Kosovës. “Qeveria është pothuajse jashtë lojës sa i përket intervenimit në situata të tilla, ku variacionet e çmimeve të produkteve bazë, por edhe të produkteve tjera kanë lëvizje të pakontrolluar në tregun tonë”, thotë Shala për Radion Evropa e Lirë.

Për eliminimin e efekteve të rritjes së çmimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës (MINT) hartoi në vitin 2022 Projektligjin për mbrojtjen e furnizimit me produkte themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, i cili po atë vit u miratua edhe në Kuvendin e Kosovës.

Por, në një deklaratë dhënë Radios Evropa e Lirë, kjo

ministri kujton se ligji u dërgua ndërkohë në Gjykatën Kushtetuese, e cila në fund të vitit të kaluar e shpalli të pavlefshëm, pasi, siç tha, nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

MINT nuk tregoi nëse është në proces të ndërmarrjes së ndonjë mase tjetër.

“Rritje artificiale”

Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë i Kosovës, Ismet Mulaj, e quan artificiale rritjen e çmimeve. Sipas tij, atë e bëjnë fillimisht tregtarët importues, ndërsa çmimet e produkteve vendore, më pas, sinkronizohen me ato të produkteve të importuara.

Kosova importon shumicën e produkteve nga jashtë - nga ato ushqimore deri te tekstili e materiali ndërtues.

Për Mulajn është “absurde” rritja e çmimeve të prodhimeve bujqësore në kohën kur në treg kanë dalë prodhime nga fushat e Kosovës. “... pra, prodhuesi vendor nuk po u ik çmimeve të importeve”, sipas tij.

Shaban Bislimi, i cili tash e gati 30 vjet shet perime në Tregun e

Gjelbër në Prishtinë, thotë se çmimet e produkteve varen nga “tregtarët e mëdhenj”, por nuk tregon se për kë konkretisht e ka fjalën. “Ata e importojnë mallin dhe ne e blejmë”, thotë Bislimi dhe shton se nga malli i blerë, fiton 10-15% të shumës.

Pikërisht këta tregtarë, që i përmend ai, Mulaj thotë se duhet të monitorohen nga institucionet kompetente. “Nëse ka deformim të çmimeve, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës e ka për detyrë të shohë se kush janë tregtarët që i sjellin këto produkte. Pse po rriten çmimet në këtë kohë? Dogana i ka të dhënat se kush janë katër apo pesë tregtarët që importojnë më së shumti produkte bujqësore nga rajoni dhe më gjerë...”, thotë Mulaj.

Duke iu përgjigjur interesimit të REL-it, Autoriteti i Konkurrencës thotë se nuk e ka në mandat t’i rregullojë çmimet e ndonjë produkti apo shërbimi. “Autoriteti reagon në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në mënyrë të koordinuar, [për të parë] nëse një veprim i tillë është rezultat i marrëveshjes së tyre”, thuhet në përgjigje.

Aty, po ashtu, theksohet se në këtë kontekst do të monitorohet edhe situata në tregun e produkteve të importuara dhe, në rast të parregullsisë, do të ketë “reagime sipas detyrës zyrtare”.

Inspektorati i Tregut nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it për këtë temë.

Rritja e çmimeve në Kosovë mori hov nga viti 2022.

Si gjetiu në botë, inflacioni filloi të rritej pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës, në shkurt të atij viti. Ndërkohë, inflacioni ra, por jo edhe çmimet.

Paga mesatare në Kosovë është 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro. “Shpesh dal të blej në treg, por shpesh nuk më mjaftojnë paratë”, thotë Sylejmani, i cili pensionin e ka 100 euro.

Valuta euro, e vetme për transaksione në Kosovë

PRISHTINË, 12 MAJ- Të shtunën ka përfunduar periudha transitore e Bankës Qendrore të Kosovës rreth çështjes së dinarit, ndërsa që nga sot ndaj gjithë atyre që përdorin valuta të tjera përpos euros për transaksione me para të gatshme në Kosovë, do të ndërmerren masa.

Në kuadër të kësaj periudhe, nuk janë shqiptuar masa ndëshkuese, por janë ofruar informacione për qytetarët rreth zbatimit të rregullores

për pagesa me para të gatshme.

Ndërsa, bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë udhëzuar që të hapin degë të reja në veri.

Pas 12 majit të gjitha transaksionet me para të gatshme kudo në Kosovë duhet të bëhen me euro. “Valutat tjera jo euro mund të përdoren në Republikën e Kosovës si vlera për ruajtje në formë fizike apo në llogaritë bankare në valuta jo euro, për

kryerjen e pagesave ndërkombëtare në valuta jo euro dhe për aktivitetet e këmbimit valutor”, citohet në rregulloren e BQK-së.

Zbatimi i rregullores sidomos në veri të vendit vlerësohet se mund të jetë sfidues.

Kryeministri Albin Kurti, i pyetur ditë më parë për përfundimin e fazës transitore ka ritheksuar se Banka Qendrore është ajo që vendos për çështje të tilla, e jo ekzekutivi.



Eurovizioni si arenë politike



Nga: Gaby HINSLIFF / *The Guardian* (titulli origjinal: *Eurovision is a joyful, powerful event – but it can't carry the weight of the war in Gaza*)

A ke me përcjell Eurovizionin në këtë fundjavë? Dikur ishte pyetje mjaft e sinqertë. Por, shpejt po bëhet ngjarje e ngarkuar, si ngjarja më e kotë, pa substancë, si ngjarja më e madhe e kësaj zëbrimit në muzikë që po përplaset me një krizë politike të cilën mjerisht duket e paaftë për ta trajtuar. Paramendoje një festë të dehur të grave, që aksidentalisht përplaset në një procesion funerali.

Kjo nuk është hera e parë që konkursi vjetor i këngës zhvillohet nën hijen e luftës. Por, është hera e parë që ta kujton pjesëmarrësin e Britanisë i cili shpërtheu në lot në një intervistë, duke rrëfyer se ishte “izoluar në një dhomë hoteli, në përpjekjen për të mos u thyer mendërisht” për shkak të presionit që të largohej; ose, garuesit e tjerë që po bëhen cak i kritikave nga ky nivel zemërimi. Policia e armatosur tani po e vëzhgon arenën, ndërsa qyteti mikpritës suedez i Malmos përjetoi mijëra njerëz të cilët të enjten mbrëma iu bashkuan protestave në rrugë, teksa tensionet po rriten nga kërcënimi për pushtim tokësor

të Rafahut nga Izraeli. Sepse kjo, natyrisht, ka të bëjë me Gazën. Pasi lobuan pa sukses që Izraeli të ndalohej nga Eurovizioni, siç ndodhi me Rusinë pas pushtimit të Ukrainës, aktivistët pro-palestinezë prej javësh kanë kërkuar nga shikuesit dhe pjesëmarrësit që ta bojkotojnë shfaqjen. Epo, mjaft e drejtë: të gjithë i kemi vijat tona të kuqe, dhe derisa refuzimi për të parë TV-në duket se nuk ka gjasa të ndikojë në kërcënimin e Joe Bidenit për të ndaluar disa dërgesa të armëve, bojkotet kulturore prej kohësh kanë pasur rol në shprehjen e një lloji të pafuqishëm të zemërimit që shumë njerëz ndiejnë për Gazën. Kandidati premtues britanik i Eurovizionit, Olly Alexander, i cili është homoseksual, iu përgjigj siç duhet thirrjes së bojkotit nga grupi i fushatës Kuirët për Palestinën [Queers for Palestine], me një deklaratë të formuluar me kujdes që miraton armëpushimin e menjëhershëm, kthimin e pengjeve dhe të drejtën e civilëve palestinezë dhe izraelitë për të jetuar të sigurt, por duke arritur në përfundimin se braktisja “nuk do të na sillte më afër qëllimeve tona të përbashkëta”. Megjithatë, ajo që pasoi kur postoi publikisht në Instagram, ishte një përrua i abuzimeve në internet, duke pasur cak burrin që ka qenë i

hapur për vuajtjet në të kaluarën nga bulimia dhe vetëdëmtimi, dhe i cili vitin e kaluar u denoncuua për nënshkrimin e një letre të veçantë që akuzonte Izraelin për gjenocidin në Gazë. Ka ndryshim thelbësor midis përkrahjes së bojkoteve dhe turmave të trollëve ngacmojnë individët të cilët nuk i respektojnë; ka një humnerë të mërziqshme mes kërkimit të paqes dhe kërcënimit të muzikantëve të trazuar.

Bambie Thug e cila e përfaqëson Irlandën, ka qenë nën presion të ngjashëm duke paralajmëruar se artistët po bëhen “shënjestra të lehta”. Ndërkohë, në qendër të të gjithave është 20-vjeçarja izraelite Eden Golan – e cila e përfaqëson një vend i cili u rrëmbye nga masakra e tmerrshme dhe që në të njëjtën kohë për kundërpërgjigje akuzohet për kryerjen e krimeve të luftës, – e cila është e rrethuar nga siguria e rreptë pasi thuhet se ka marrë kërcënime me vdekje. Vetë jeta e Golanit është formësuar nga jo një, por dy konflikte: lindi në Izrael nga prindërit me origjinë ukrainase dhe letoneze, u rrit kryesisht në Rusi, por familja u kthye në Izrael pas pushtimit të Ukrainës. Do të shërbente në ushtri, nëse thirrja në shërbimin kombëtar nuk do të vonohej – për ta lënë për të konkurruar në Malmo; megjithatë, ashiqare si këngëtare

po mbahet publikisht më shumë përgjegjëse për zhvillimin e kësaj lufte, sesa që do të akuzohej si ushtarë.

Nëse denoncon, ajo do të akuzohet në vend për tradhtinë e shtetit që ia dha strehën prindërve të saj. Nëse dështon për ta bërë këtë, kur numri i të vdekurve në Gazë po i afrohet shifrës 35 mijë, ajo rrezikon të flaket nga skena. Megjithëse flamujt palestinezë nuk lejohen në arenë, dhe Bambie Thug-it i është kërkuar të ndalojë së shkruari në fytyrë dhe në trup fjalën mesjetare irlandeze për “armëpushimin”, disa spektatorë nuk u ndalën së shari Golanin në gjysmëfinale. Të shtunën mund të na presë një natë e pakëndshme.

Edhe pse kritikët e akuzojnë Eurovizionin për “përfitime nga LGBT-ja” ose për lejimin e Izraelit për ta spastruar reputacionin, këtë vit askush nuk duket se do të dalë i pastër. Ashtu si FIFA gjatë betejave të futbollit, Eurovizioni pretendon se ngrihet mbi politikën – por, në realitet nuk mund t'i shpëtojë asaj. Fitorja nuk ka të bëjë kurrë vetëm me këngën, por edhe aleancat e vjetra që ndikojnë në vota. Por, kur hyrja e Ukrainës triumfoi në vitin kur Rusia nisi pushtimin e saj në shkallë të plotë, kishte diçka vërtet prekëse në konkursin që Liverpuli më pas organizoi në emër të saj, duke

treguar se Evropa është e bashkuar mbi diçka më të thellë se muzika. Megjithëse natyra e konfliktit të tyre historik është më ndryshe, mund të kuptohet se pse palestinezët e dëshirojnë një deklaratë po aq të fuqishme – se Gaza nuk është vetëm.

Është qesharake, natyrisht, të presësh që organizatorët e një konkursi limonadë të zgjidh lëmshin që ka mundur presidentët: është gjithashtu gabim të ngarkosh barra kaq të rënda mbi një grup të yjeve të popit që kurrë nuk janë zgjedhur për aftësitë e veta diplomatike.

Megjithatë, si të gjitha konkurset e famshme, Eurovizioni është pasqyrë në të cilën vendet mund ta shohin veten ashtu siç i shohin të tjerët, dhe ky vit nuk përbën ndonjë përjashtim. Ndjenja e qytetarëve të zakonshëm të pafuqishëm për të ndihmuar; brengat private të liderëve që mbështetën të drejtën e Izraelit për t'u mbrojtur pas masakrës së 7 tetorit, por që ndjehen të kompromentuar nga sjellja në luftën që rezultoi; kapaciteti i pakrahasueshëm i mediave sociale për të shkatërruar gëzimin në çdo gjë, teksa çdo argument moral dhe kompleks bie në sarkazëm – gjithçka pasqyrohet në topin vezullues që në mënyrë groteske shkëlqen te ne. A po e sheh Eurovizionin? Apo këtë ai po na shikon?

/Telegrafi/

Kadare, pse ky polarizim?



Nga: Çapajev GJOKUTAJ

Sa herë që ka ndonjë lajm për Ismail Kadarenë, rigjallërohen në rrjetet sociale qasjet e njohura ndaj shkrimtarit, qasje që strukturohen në gjedhin e kahershëm: dy grupe me qëndrime krejt të kundërta; njeri e vlerëson deri në kufijtë e idealizimit, i dyti e kritikon duke kaluar hera herës në viset e mohimit. Asgjë e re nga fronti i opinionit popullor për shkrimtarin tonë të shquar, mund të thoshe në një vështrim të parë e të sipërfaqshëm.

Që nga vitet 1960 e deri në ditët tona, për treçerek shekulli me radhë diskutimet për Kadarenë kanë gjeneruar vazhdimisht polarizime të tilla. Vetëm se kur e sheh dukurinë më nga afër, dallon se ka diçka të diskutueshme, madje edhe vështirë të shpjegueshme: kanë ndryshuar çuditshëm motivet e grupit kundër, thënë ndryshe motivet e detraktorëve për marrëdhëniet me diktaturën.

Në postime "Fejsbuku" e komentet përfund tyre, sillen zakonisht vargjet që Kadare pat shkruar për partinë, postohet e ripostohet një vjershë e kahershme për qenin e kufirit, përmendet me ironi disidenca e vetëpretenduar, rikujtohen artikujt e Kadaresë kundër vlerave letrare të Fishtës etj. Lista mund të shkonte gjatë, po kritikën më të hasura mbeten ato që mund të përmbledheshin në sintagmën "shkrimtar oborri".

Ngjan tejet e çuditshme, por në periudhën totalitare argumentet për ta kritikuar e sulmuar shkrimtarin kishin motive të kundërta, shumica e tyre përmbledhej në shprehje të tipit 'nuk shkruan për popullin po për të huajt', 'ia ka me hile partisë, se shumë gjëra mund të lexohen edhe ashtu, edhe kështu' etj. Thënë shkurt, dje sulmohej për

herezi ndaj diktaturës, kurse sot për shërbime ndaj saj, dy gjëra këto që e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe vështirë të artikulohej nga të njëjtët persona. Rrjedhimisht e me logjikë aritmetike mund të thuash se ata që e kritikonin a mohanin dje nuk janë po këta të sotmit.

Edhe kështu mund të jetë, se dukuria është treçerekshkullore ndaj dhe në grupin kundra s'ka si të jenë të njëjtët njerëz, jeta bën të vetën, shumë kanë ikur e janë tretur, ndërkohë që shumë të tjerë janë bërë të zëshëm në tri dekadat e tranzicionit. Megjithatë, vështirë të thuash se grupi është krejt i rinovuar dhe në të nuk bëjnë pjesë edhe kritikues e mohues të djeshëm. Nuk dihet dhe vështirë të hamendësosh se ç'masë të detraktorëve të tanishëm përbëjnë këta që dje e kritikonin për herezi kundër regjimit, kurse sot e venë në shënjestër për të kundërtën. Gjithsesi, mendja ta do se sado pak të jenë motiv kryesor dhe të vetëm kanë smirën e provincialit për talentin që bota e pranon dhe e vlerëson.

Qasja e polarizuar ndaj Kadaresë mund të kuptohet më mirë po që se shihet si pjesë e një dukurie më të gjerë, me gjasë botërore. Në fakt, nuk janë një a dy shkrimtarët e shquar që kanë arritur njohje dhe vlerësim ndërkombëtar, por në vendin e tyre, sidomos në fillim, nuk janë vlerësuar nga një pjesë e opinionit publik. Ndër ta mund të rendisë Orhan Pamuk, Salman Rushdie, Gabriel Gracia Marquez, Vidiadhar Naipaul, Chinua Achebe, Milan Kundera, Mario Vargas Llosa etj. Vetëkuptohet se detraktorët e gjithë këtyre dhe të tjerësh të këtij lloji, duke qenë të shpërndarë në kohë dhe në kontekste krejt të ndryshme, motivohen nga llojlloj arsyesh sociale, politike, estetike, historike etj. Megjithatë, disa motive i gjen të përsëritura shpesh dhe si të tilla synojnë të

krijojnë një farë norme. Këtu do të hynin: pikëpamjet e kundërta politike e ideologjike, koncepte të ndryshme për identitetin të përcaktuara nga kundërvëniet qasjesh provinciale e folklorike me qasje universale e kozmopolite, pëlqime të ndryshme për modernen dhe tradicionalen në stil dhe në narrativë, zili dhe xhelozitë të establishmenteve letrare vendase, por edhe të një pjese të publikut etj.

Pothuajse të gjitha këto motive, që i gjeje shpesh edhe tek detraktorët e Kadaresë gjatë periudhës totalitare, sot janë bjerrë për t'u lenë vetëm shtysave politike ose, siç e thamë, akuzave që përmbledhen në etiketën 'shkrimtar oborri'. Sot nuk diskuton kush më në rrafshet: është tradicional apo modern, metaforik apo metonimik, i destinuar për intelektualët e për të huajt apo për njerëzit e tabanit, përcjell ambiguitet e alegori estetizante apo qartësi e vendosmëri militanti etj. Detraktorët përsërisin e stërpërsërisin disa fakte klishe, duke u kujdesur që edhe këto të jenë të njëanshme e të shpëputura nga roli i vyer emancipues, që ka luajtur vepra e Kadaresë në lexuesit e periudhës totalitare.

Natyrisht është në të drejtën e individit apo të grupimeve të ndryshme të zgjedhin për çfarë do diskutojnë edhe kur vjen fjala për shkrimtarë e për letërsi. Në kuadër të kësaj të drejte kushtetuese, që lidhet me lirinë e shprehjes, do të tingëlonte si censurë, po të bëje policin e opinionit dhe të caktoje ku duhet përqendruar diskutimi dhe, aq më pak, çfarë duhet thënë e çfarë duhet lënë.

Gjithsesi, akuzat e detraktorëve për shërbime ndaj diktaturës ngajnë të ndërtaura mbi gjysmë të vërteta si dhe mbi seleksionim tejet tendencioz të fakteve. Për t'u dhënë jetë këtyre akuzave e për t'i

bërë ato më bindëse, detraktorët harrojnë ose injorojnë rastet kur krijimtaria e Kadaresë grishte për kundërvëniet me institucionet, praktikën dhe frymën totalitare. Dhe këto s'janë të rralla.

Tabir Saraj p. sh., institucioni grotesk që tregonte frikshëm prirjen e shtetit totalitar për ta kontrolluar individin dhe për të hyrë deri në kthinat më të thella të privatësisë së tij, në ëndrrat e gjumit, u lexua edhe nga qarqet zyrtare të kohës si "aluzion për institucionet tona". Ritregimi mjeshër i legjendave të moçme shqiptare u shfrytëzua nga Kadareja për të plazmuar idenë e identitetit evropian të shqiptarëve dhe më tej shpëputjen brutale nga kontinenti mëmë dhe lidhjen e përdhunshme pas një perandorie obskurantiste. Vetëkuptohet si do të lexoheshin nga banorët e një vendi të mbyllur dhe të vetizuar të gjitha këto. Lënë mënjanë raste të tjera të këtij lloji, vepra e Kadaresë në tërësinë e saj, me etjen e fuqishme për novatoren dhe bashkëkohoren luante rol të dukshëm emancipues, mes të tjerash nxiste breza të tërë të rinjsh për të synuar modernen, eksperimentin, lirinë.

E tepërt të thuash se detraktorët janë vetëm një pjesë e atyre që shkruajnë e flasin në rrjetet e sotme sociale për Kadarenë dhe veprën e tij. Madje, ngjan se janë një pjesë e vogël krahasuar me ata që e çmojnë dhe e admirojnë. Gjithsesi, kur gjykon raportet mes mbështetësve dhe kontrastve mund të gënjejesh dhe iluzionin ta marrësh për realitet. Detraktorët apo kontrastit ngajnë se janë më shumë sesa në realitet, ngaqë bëjnë më shumë zhurmë, por edhe ngaqë algoritmet, që koordinojnë funksionimin e rrjeteve sociale, janë ndërtaur në mënyrë të tillë që të nxisin me përparësi vëmendje për negativën dhe të lënë dis në hije pozitiven. Ka edhe diçka tjetër. Dikur diskutimet pro dhe kundër

Kadaresë zhvilloheshin përgjithësisht në trajtë debatesh, kryesisht orale, në kafene, në ambientet e shkollës, në bordura vendesh publike etj., por gjithsesi ishin dhënie e marrje argumentesh e vlerësimesh mes palëve dhe, si të tilla ndihmonin krijimin e një opinionit sa më real dhe shoqërisht të dobishëm. Sot në rrjetet sociale këto diskutime zhvillohen brenda hapësirash virtuale që në gjuhë teknike quhen "echo chambers". Algoritmi, për interesa të paracaktuara nxit krijimin e këtyre hapësirave ku individit ndesh vetëm opinione a besime që i vijnë për hosh dhe çimentojnë bindjet a paragjykimet që ka, duke mënjanuar e mohuar palën tjetër, qëndrimin alternativ. Natyrisht që e njëjta gjë ndodh edhe me admiruesit dhe vijnë në situatën kur secila palë ndihet zot në kullën e saj, jo vetëm pa kontakte me palën tjetër, por edhe larg veprës së Kadaresë; thuajse gjithçka që thonë e shkruajnë janë riciklime opinionesh e tifozllëqesh të mëhershme, të zbërdhlytura nga përdorimi i shumtë.

Kjo mbyllje kontrastuese, disa në kullat e kritikës e të denigrimit dhe disa në ato të vlerësimit e të admirimit, bëhet më shqetësuese po t'i shtosh heshtjen që vjen nga qarqet letrare dhe nga ato akademike, heshtje që me kalimin e viteve sa vete e po bëhet më e thellë e më e patrazuar. Të krijohet përshtypja se veprën e Kadaresë e kemi kthyer në ikonë dhe po e mbyllim në kamare rreth të cilës gumëzhin një gërmër pëshpërimash ikonoklastie a ikonolatrie, të artikuluara jo aq për hir të veprës sa për tifozllëk dhe marazë të paqilruara. Ia vien të kujtojmë më shpesh se korpusi kadarean është pasuri e çmuar kombëtare dhe, si çdo thesar apo kapital, nuk e ka vendin në muze a në qyp, po në qarkullim e riqarkullim të përditshëm, për të krijuar e rikrijuar vlera të reja.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Arsenali fiton derbin ndaj Unitedit

MANCHESTER, 12 MAJ - Gara për titullin kampion të Premier Ligës mes Manchester Cityt dhe Arsenalit do të jetë spektakolare deri në fund. "Topçinjtë" triumfuan 1-0 të

dielën në "Old Trafford", përballë United dhe ngjiten në krye të klasifikimit me 1 pikë më shumë se skuadra e Pep Guardiols. "Qytetarët" mund ta marrin kreun me një

sukses të mundshëm në ndeshjen e prapambetur me Tottenhamin në Londër. Golin që i dha tri pikët e radhës Arsenalit në ndeshjen me Manchester United e

shënoi Trossard në minutën e 20-të. Në ndeshjen e javës së 38-të dhe të fundit të Premier Ligës Arsenali pret Evertonin, ndërkohë që City pret West Ham.



Ballkani e Llapi vazhdojnë me fitore, Drita ngec

"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 MAJ - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Ballkani ka bërë edhe një hap të madh në rrugën drejt titullit kampion në Superligë, pasi e mposhti të dielën, Fushë Kosovën me rezultat 3-0. Golat e fitores për skuadrën lidere i shënuan Walid Hamidi, Almir Kryeziu dhe Bernard Karrica. Pas kësaj fitore, Ballkani arriti në kuotën e 72 pikëve, duke e ruajtur epërsinë prej katër pikësh ndaj skuadrës së Llapit. Kjo e fundit, shënoi fitore para

tifozëve të vet në duel me Malishevën, me rezultat 1-0, për t'i mbajtur gjallë shpresat për titull edhe më tutje, kur kanë mbetur edhe dy javë deri në mbyllje të këtij edicioni. Golin e fitores për llapjanët e shënoi Ahmed Januzi. Në javën e ardhshme Llapi do të jetë mikpritës i Ballkanit, ndeshje kjo e cila pritet të dhurojë emocione të mëdha. Ndërkohë, Drita pas barazimit të sotëm në shtëpi ndaj Feronikelit 74 (0-0) duket se është dorëzuar në garën për titull, pasi tashmë ngec 6 pikë me liderin. E fitores iu gëzua Dukagjini në duel me



Prishtinën (1-0), me golin e Redon Sylës, sikurse edhe

Gjilani si mysafir i Lirisë në Prizren (3-1), me dy gola të

REZULTATET	
Liria - Gjilani	1-3
Llapi - Malisheva	1-0
Ballkani - Fushë Kosovë	3-0
Dukagjini - Prishtina	1-0
Drita - Feronikeli 74	0-0

TABELA	
	Pikë
1. Ballkani	34
2. Llapi	34
3. Drita	34
4. Malisheva	34
5. Prishtina	34
6. Dukagjini	34
7. Gjilani	34
8. Feronikeli 74	34
9. Fushë Kosova	34
10. Liria	34

Kushtrim Shabanit dhe një gol të Senad Jaroviqit.

Ylli barazon serinë finale ndaj Trepçës

SUHAREKË, 12 MAJ - Në një ndeshje të çmendur, Golden Eagle Ylli ka mundur Trepçën 80:79 (23:18, 18:16, 19:7, 20:38) për të barazuar serinë finale të "play-off"-it 1:1. Përballja ka qenë e jashtëzakonshme, me therandasit që kishin deri në 21 pikë epërsi, por mitrovicasit u rikthyen dhe dy herë ngushtuan shifrat në vetëm një pikë, por nuk ia arritën qëllimit të triumfojnë, derisa sfida është zhvilluar në një atmosferë të bukur sportive me tifozë nga Theranda dhe Mitrovica. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 23:18, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, për të ngritur më shumë epërsinë, për të shkuar në pushim me shifrat 41:34. Ylli shkëlqeu në periodën e tretë, si në mbrojtje ashtu edhe në sulm, për tu shkëputur në 60:40, kurse në



fillim të dhjetëminutëshit ngritën epërsinë në 62:41, që ishte më e larta e ndeshjes. Por, nga ky moment mitrovicasit e nisën një seri të jashtëzakonshme, për të ngushtuar rezultatit në 72:71, për të bërë ndeshjen e çmendur. Therandasit sërish u shkëputën në 78:71, por 'Xehetarët' sërish u rikthyen për 80:79, por nuk arritën të bëjnë më shumë dhe Ylli barazoi

serinë finale në 1:1. Te vendasit u dalluan Jalen Nesbitt me 14 pikë, dhjetë kërcime e tri asistime dhe Alonzo Verge JR me 27 pikë, tri kërcime e katër asistime, kurse te mysafirët Mikailë Tmusiq kishte 17 pikë, tri kërcime e tri asistime. Ndeshja e ardhshme zhvillohet të enjten në Mitrovicë, derisa kampion shpallet skuadra që shënon tri fitore.

KFF Mitrovica, kampione e Sigal Superligës

MITROVICË, 12 MAJ - KFF Mitrovica është kurorëzuar me titullin e kampionit në Sigal Superligën e Kosovës në konkurrencën e femrave. Ceremonia e dekorimit të kampionit u organizua nga Federata e Futbollit e Kosovës pas ndeshjes së javës së 20-të, ndërmjet Mitrovicës dhe Llapit, e cila u mbyll me fitoren bindëse të mitrovicasve, me rezultat 8:0. Trofeun për kapitenen Kaltrina Biqkaj e ndau presidenti Agim Ademi, derisa medaljet i ndanë Vjollca Krasniqi, Xhelal Broja e Ismajl Ajeti, anëtarë të KE të FFK-së, Përparim Drini drejtor gjeneral i Sigalit në Kosovë, Vesa



Broja, kryesuese e Asamblesë komunale në Mitrovicë dhe drejtori për sport në këtë komunë, Fahri Jashari. Të pranishëm në ceremoninë e shpalljes së kampionit ishin edhe personalitete të shquara të futbollit mitrovicas, si Ajet Shosholli, Rafet Prekazi e Gani Sejdiu. Për KFF Mitrovicën ky është titulli i pestë i kampionit.

Besa e Pejës promovohet në Superligë

PEJË, 12 MAJ - Besa e Pejës është kampione në Ligën e Parë të Kosovës në hendboll. Hendbollistet e skuadrës pejane kanë fituar titullin pas një kampionati të fortë e

interesant. Besa kishte konkurrencë të fortë nga Verona e Vjosa, por triumfoi në fund. Verona përfundoi nënkampione dhe do të luaj në barazh për vend në Superligë.

Ndërkohë Besa promovohet në elitën e hendbollit kosovar për edicionin e ardhshëm garues, 2024/2025. Kupa e kampionit, skuadrës së Besës i është dorëzuar të dielën. Dorëzimin e

kupës e bënë kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe komesari i garave të FHK-së, Isak Osmani. Federata e Hendbollit e Kosovës e uron KHF Besën për



suksesin e arritur dhe i dëshiron suksese në Superligë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "GranD-Pe" shpk - Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Prodhimin e artikujve të plastikës për paketim (qeseve të plastikës) në Vitomiricë të Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.06.2024 në ora 11:00 në Shkolla Fillore 7 Shtatori, Vitomericë, Rajoni i Parë, Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania "GranD-Pe" shpk - Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Prodhimin e artikujve të plastikës për paketim (qeseve të plastikës) në Vitomiricë të Pejës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "GranD-Pe" shpk - Pejë, për Impiantin për Prodhimin e artikujve të plastikës për paketim (qeseve të plastikës) në Vitomiricë të Pejës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Niki 999" Sh.p.k Dragash, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin për Prodhimin e Betonit, ZK. Dragash.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.06.2024 në ora 14:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Dragashit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Niki 999" Sh.p.k Dragash, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Impiantin për Prodhimin e Betonit, në Dragash.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Niki 999" Sh.p.k Dragash, për Impiantin për Prodhimin e Betonit, në Dragash.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania KRM "Uniteti" sh.a Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Deponinë e Mbeturinave Gërmova, në ZK. Koshtovë, Komuna e Mitrovicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.06.2024 në ora 10:00 në ShFMU "Shaban Idrizi" në fshatin Zhabar, komuna e Mitrovicës, do të organizohet debat publik nga Kompania KRM "Uniteti" sh.a Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën, për Deponinë e Mbeturinave Gërmova, në ZK. Koshtovë, Komuna e Mitrovicës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwvrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë KRM "Uniteti" sh.a Mitrovicë, Deponinë e Mbeturinave Gërmova, në ZK. Koshtovë, Komuna e Mitrovicës

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojme të gjithë klientet se Kompania TWELVE PZ SH.P.K me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Nui- 811321223 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raporte Kreditore – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo sve kupce (kliente) da Tvrtka TWELVE PZ D.O.O sa sjedištem u Prizrenu doneo odluku zatvoriti biznis sa Jedinstvenim Maticnim Brojem (JMB): 811321223 I ujedno imenovao Likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi kupci (klienti) koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company TWELVE PZ LLC in Prizren has come to the decision to quit its business with registry: 811321223 The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All cliets who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

